



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1131 / Prot.
8

Tiranë, më 21/12/2016

REKOMANDIM

Nr. 36, datë 21/12/2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30/04/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "Global Travel", Tiranë.

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 228, datë 21.10.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye helimi administrativ pranë kontrolluesit "Global Travel" (Nipt K42201801Q), me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.

Kontrolluesi "Global Travel" ka si objekt të veprimtarisë tregtare ofrimin e shërbimit në fushën e turizmit dhe transportin ndërkombëtar të udhëtarëve. Gjatë ofrimit të shërbimeve përpunon të dhëna personale kryesisht për kategorinë e subjekteve të të dhënave "klientë", manualisht dhe në format elektronik, përmes programeve Galileo, Amadeus, Odeon.

1. Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave "Klientë" dhe "Punëmarrës". Për kategorinë "klientë" kontrolluesi përpunon të dhënat; emër, mbiemër, nr. pasaporte, nr. telefoni/celulari, adresë e-mail, datëlindje. Për kategorinë "punëmarrës", kontrolluesi përpunon të dhëna të identifikimit (emër, mbiemër, numrin e sigurimit shoqëror, numrin personal të identifikimit), nëpërmjet administrimit të dokumenteve në dosjen e punës, për qëllime të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Kontrolluesi gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij përpunon të dhëna personale përmes sistemeve të procesimit dhe lëshimit të biletave elektronike: Galileo dhe Amadeus, si dhe ndërfaqes-online Odeon për rezervimet e hoteleve në Turqi. Operatorët e kontrolluesit aksesojnë përmes internetit këto sisteme me llogari të veçanta emër/fjalëkalim.

Kontrolluesi është agjensi e akredituar nga (IATA – International Air Transportation Authority) dhe në këtë kuadër autorizohet të përdorë sistemet Galileo dhe Amadeus. Në dokumentin “Termat dhe Kushtet” (*Terms and Conditions*) e paraqitur në dosjen e aplikimit në IATA, nuk ka parashikime lidhur me mënyrën e përpunimit të të dhënave personale të klientëve. Zyra e Komisionerit vlerëson se parashikimi i rregullave mbi mënyrën e përpunimit dhe sigurinë e të dhënave personale të klientëve paraqet një kusht kryesor në kuadër të garantimit të detyrimeve ligjore dhe përbën një garanci për një përpunim të ligjshëm.

2. Kontrolluesi nuk ka përcaktuar afat për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale të klientëve, në kundërshtim me nenin 5/1/d të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se përcaktimi i afatit është një element i rëndësishëm në përpunimin e të dhënave në mënyrë të ligjshme pasi lidhet me parimet e përpunimit të të dhënave personale (të dhënat duhet të përpunohen për sa kohë ekziston qëllimi i përpunimit).

3. Grupi i hetimit administrativ konstatoi se Kontrolluesi gjatë ushtrimit të aktivitetit nuk i informon subjektet e të dhënave personale “klientë”, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë (sipas neneve 12, 13, 15, 16 dhe 17 të ligjit), afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Në këtë kuadër, lind nevoja që në kontratat që kontrolluesi nënshkruan me klientët të parashikohet detyrimi për informim në përputhje me nenin 18 të ligjit.

Gjithashtu, në faqen e internetit të kontrolluesit www.globaltravel.al nuk është i parashikuar informimi nëpërmjet rubrikës “Politikat e privatësisë”. Çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes online në internet, ka detyrimin që të publikojë “Politikat e privatësisë”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes online në internet.

Reflektimi në kontratë i detyrimit për informim dhe publikimi i “Politikave të privatësisë” realizon qëllimin që ka neni 18 i ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

4. Kontrolluesi nuk ka hartuar një “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të klientëve dhe punonjësve, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar;

Hartimi i rregullores është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës, dhe përcakton standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale. Rregullorja duhet të jetë

gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektsh të të dhënave).

Në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të stafit menaxherial dhe stafit operacional, në nenin 12 pika 1, citohet vetëm që në detyrat e menaxherit të shërbimeve mbështetëse një ndër pikat është që të informojë strukturat drejtuese në zbatimin e legjislacionit shqiptar si dhe ligjin për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale të klientit.

Gjithashtu në kontratën individuale është një aneks 1 shtojcë e kontratës individuale të punës, në të cilën përcaktohen detyrimet e operatorit/përpunuesit por ku nuk janë përcaktuar saktë masat e sigurisë dhe afati i mbajtjes së të dhënave.

Zyra e Komisionerit vlerëson se këto parashikime nuk janë të mjaftueshme për të plotësuar detyrimet ligjore në kuadër të garantimit të një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale.

5. Në marrëveshjen që kontrolluesi "Global Travel" ka nënshkruar me kompaninë "Odeon Tourism" (në cilësinë e përpunuesit) nuk janë parashikuar detyrime në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale të klientëve, në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Parashikimi i këtyre detyrime është thelbësor për të garantuar sigurinë e të dhënave dhe përpunimin e ligjshëm nga ana e kompanisë "Odeon Tourism" (në cilësinë e përpunuesit).

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30/04/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", u caktua ora 11:00 e datës 13/12/2016 për zhvillimin e seancës dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Përfaqësuesi i kontrolluesit "Global Travel", gjatë seancës dëgjimore, ka dokumentuar realizimin e masave të marra në kuadër të konstatimeve të grupit të kontrollit, duke paraqitur aktet si vijon:

- Rregullore e brendshme për Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale (në zbatim të nenit 27 të ligjit);
- Politikat e Privatësisë të publikuara në faqen online;
- Email drejtuar kompanisë Odeon Tourism Int., në lidhje me përfshirjen në kontratën e vitit 2017 të aneksit për garantimin e sigurisë së mbrojtjes së të dhënave të klientëve, si dhe përcaktimi i afateve të ruajtjes së të dhënave;
- Deklaratë informimi për klientët.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neni 31, pika 1, germa a/1,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 5/1/d të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të dhënat personale të klientëve të mbahen për aq kohë sa ekziston qëllimi i përpunimit duke përcaktuar një afat kohor të arsyeshëm për mbajtjen e të dhënave që përpunohen manualisht dhe elektronikisht. Për këtë afat duhet të informohen dhe subjektet e të dhënave (klientët);
2. Kontrolluesi “Global Travel” në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të marrë masa për të përfshirë në faqen e tij të Internetit në rubrikën “Politikat e Privatësisë”, informacionin sipas Opinioneve të Komisionerit “Mbi mbrojtjen e të dhënave personale në faqet e internetit të kontrolluesve publik dhe privat”, publikuar në faqen zyrtare www.idp.al. Detyrimi për informim të parashikohet edhe në formatin e kontratave që kontrolluesi nënshkruan me klientët;
3. Kontrolluesi “Global Travel”, në zbatim të nenit 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij;
4. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të respektohen në vazhdimësi masat teknike dhe organizative të sanksionuara në “Rregulloren e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale”, të miratuar nga kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave të klientëve;
5. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimit të parashikuar në pikën 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 15 ditor nga momenti i marrjes dijeni. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit;
6. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky rekomandim u shpall sot më datë 21, 12 2016.

